



**Organizata jo qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

11 Nëntor 2016, Prizren

**KOMUNIKATË PËR MEDIA
Transporti Urban në Prizren tashmë ka materiale informuese**

Në kuadër të krijimit të Platformës për Transportin Urban në Prizren, EC Ma Ndryshe ka dizajnuar materialet grafike informuese përkatësisht hartat e linjave urbane, orarin e shërbimit të këtyre linjave, shenjëzimet e stacioneve urbane dhe shenjëzimet brenda autobusëve, pasi paraprakisht ka definuar lokacionet dhe emërtimet e stacioneve lokale. Përmes performansës “Harta e Transportit Urban të Prizrenit dhe shenjëzimi i autobusëve” ato janë vënë në shërbim të publikut me synimin që të lehtësohet informimi i qytetarëve që e shfrytëzojnë këtë shërbim.

Në një analizë të bërë për transportin urban në Prizren, pas takimeve dhe punëtorive të organizuara nga EC dhe OPDMK me grupet e ndryshme të komunitetit, janë identifikuar problemet si mungesa e shenjëzimeve rrugore; mungesa e materialeve informuese; mungesa e stacioneve urbane; ndalesat jo të rregullta të autobusëve; pengesat në qasje të personave me aftësi të kufizuar, etj.

Për adresimin e problemeve të lartpërmendura EC dhe OPDMK kanë kontraktuar një grup të ekspertëve për prodhimin e zgjidhjeve konkrete në këtë drejtim. Në bashkëpunim edhe me kompaninë përgjegjëse për menaxhimin e këtij sektori në zhvillim e sipër është krijuar platforma e transportit urban të Prizrenit.

Pos definimit të lokacioneve dhe emërtimit të stacioneve lokale e dizajnit të materialeve grafike informuese (harta e linjave urbane, orari i shërbimit të këtyre linjave, shenjëzimet e stacioneve urbane dhe shenjëzimet brenda autobusëve), pjesë përbërëse e platformës janë edhe hartimi i manualit për transportin urban të Prizrenit; dizajni i “Stacionit Urban Model” në bazë të rregulloreve ndërkombëtare për stacionet urbane, me fokus të veçantë në standardet për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe dizajni i tabelës (shtyllës) informuese që përcakton lokacionin e stacionit lokal me të gjitha informatat përcjellëse.

Performansa “Harta e Transportit Urban të Prizrenit dhe shenjëzimi i autobusëve” është realizuar në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës...” që zbatohet nga EC Ma Ndryshe, me financim nga Olof Palme International Center (OPIC), e cila përkrahët nga Qeveria e Suedisë.

OJQ EC Ma Ndryshe
Saraqët 5, 20000 Prizren
Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-.5, 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771